



Republika e Kosovës
Republic of Kosova



Kuvendi i Komunës Hani i Elezit
Municipality Assambly of Hani Elezit

01/ Nr. 63 /2011

Në bazë të nenit 40 të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Udhëzimin Administrativ Nr.10/2010 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativë Nr.41/2006 të datës 27.12.2006 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore, nenit 32.5 të Statutit të Komunës, nenit 15.2 të Rregullores për Punë të Kuvendit, shkresës përcjellëse me numër 01/Nr.63/2011 të datës 18.05.2011 nga drejtoria për Bujqësi, Pylltari, dhe Zhvillim Rural, procesverbalin e komisionit për ndërrim destinim të pronës me numër 11-Nr.06/2011 të datës 18.05.2011, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit, në mbledhjen e mbajtur më datë: 31.05.2011 mori:

V E N D I M

PËR NDËRRIM DESTINIMI TË TOKËS BUJQËSORE

I

Me këtë Vendim LEJOHET ndërrim destinimi i përkohshëm i tokës Bujqësore për Ndërmarrjen e re Sharr Cem SH.P.K nga Hani të Elezit, për shfrytëzimin e lëndës së parë – laporit sipas kërkesës së palës me numër 02Nr.228 të parashtruar me datë 11.05.2011.

II

Pronat e Lejuara bujqësore për ndërrimin të destinimit kanë këtë sipërfaqe: 4413 m² arë e klasit të katërt pronë private, 6760 m² mal të klasit të katërt pronë private, 18147 m² arë e klasit të gjashtë pronë private, 25471 m² arë e klasit të shtatë pronë private të cilat gjenden në vendin e quajtur "FUSHA" zona kadastrale Dimcë, të evidentuar në emër Ndërmarrja e re Sharr Cem SH.P.K, sipas Fletës Poseduese Nr.0075. Sipërfaqet të cilat janë në pronësi shoqërore qirambajtje-99-vite: 181 m² arë e klasit të katërt pronë shoqërore qirambajtje-99-vite, 3399 m² arë e klasit të pestë pronë shoqërore qirambajtje – 99 – vite, 12778 m² arë e klasit të gjashtë pronë shoqërore qirambajtje – 99 – vite të cilat gjenden në vendin e quajtur "FUSHA" zona kadastrale Dimcë të evidentuar në emër të Ndërmarrjes së re Sharr Cem SH.P.K Qirambajtje–99 – vite sipas fletës poseduese Nr.0026.

III

Ky Vendim hy në fuqi ditën e aprovimit, ndërsa do të zbatohet pas pagesës së përcaktuar në bazë të Udhëzimit Administrativë Nr.10/2010 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativë Nr.41/2006 të datës 27.12.2006 për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore.

IV

Për Zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesën: Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural në bazë të ligjeve në fuqi.

V

Ndërmarrja e re Sharr Cem SH.P.K në afat ligjor duhet të i filloj punimet për eksploatimin e lëndës së parë në të kundërtën do të shfuqizohet vendimi i dhënë nga Kuvendi i Komunës. Pas përfundimit të eksploatimit të lëndës së parë obligohet Ndërmarrja të bëjë rehabilitimin e të gjitha pronave.

VI

Më këtë Vendim njoftohen: Pala, Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe Arkivi i Komunës.

Këshilla juridike: pala e pa kënaqur ka drejtë të paraqes ankesë në Gjykatë në afat prej 8 (tetë) ditëve nga pranimi i këtij vendimi.

Hani i Elezit:
Data: 31.05.2011

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Menduh Vlasi

